



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

Komisioni për Politikën e Jashtme

PROCESVERBAL

Tiranë, më 12.11.2019, ora 11:00

Drejton mbledhjen:

Mimi Kodheli - kryetare e Komisionit

Rendi i ditës:

Seancë dëgjimore për emërimin në postin e kreut të misionit diplomatik të zotit Kastriot Robo, kandidat për Ambasador i Jashtëzakonshëm dhe Fuqiplotë i Republikës së Shqipërisë në Republikën e Turqisë.

Marrin pjesë:

Mimi Kodheli, Ditmir Bushati, Ralf Gjoni, Evis Kushi, Vasil Sterjovski, Andrea Marto, Vasilika Hysi, Ligoraq Karamelo, Rudina Hajdari, Ediola Braha, Zef Shtjefni, Fatmir Velaj dhe Elona Hoxha.

Mungojnë:

Eglantina Gjermani, Ervin Bushati, Adnor Shameti, Halit Valteri dhe Reme Lala

Të ftuar:

Armand Skapi- Sekretar i Përgjithshëm i Ministrisë për Europën dhe Punët e Jashtme
Kastriot Robo- kandidat për ambasador

HAPET MBLEDHJA

Mimi Kodheli - Fillojmë mbledhjen e Komisionit të Politikës së Jashtme datë 12.11.2019. Në rend të ditës kemi seancën dëgjimore për emërimin në postin e kreut të misionit diplomatik, zotin Kastriot Robo, kandidat për Ambasador i Jashtëzakonshëm dhe Fuqiplotë i Republikës së Shqipërisë në Republikën e Turqisë. Të ftuar kemi zotin Robo dhe zotin Skapi, sekretar i Përgjithshëm i Ministrisë për Europën dhe Punët e Jashtme. Mirë se vini, zotërinj!

Fjala për ju, Sekretar e Përgjithshëm. Pastaj fjalën e ka ambasadori, zoti Kastriot Robo.

Faleminderit!

Armand Skapi- E nderuar zonja kryetare,

Të nderuar deputetë,

Kam kënaqësinë të paraqes para jush, bazuar në dispozitat e ligjit për shërbimin e jashtëm, kandidaturën e zotit Kastriot Robo, për postin e Ambasadorit të Jashtëzakonshëm dhe Fuqiplotë të Republikës së Shqipërisë në Republikën e Turqisë.

Propozimi për zotin Robo në këtë post të rëndësishëm përfaqësimi diplomatik bazohet në një karrierë të gjatë tij në shërbimin e jashtëm si brenda dhe jashtë vendit.

Zoti Robo i përket gjeneratës më të hershme të diplomatëve të karrierës, që kontribuojnë në shërbimin e jashtëm. Ai e nisi karrierën e tij në vitin 1986, duke punuar si referent në Drejtorinë e Vendeve Fqinje në Ministrinë e Punëve të Jashtme, detyrë të cilën e ushtroi deri në vitin 1991. Në këtë vit karriera tij pati një ngritje, pasi për më shumë se 1 vit punoi si këshilltar në kabinetin e ministrit të Jashtëm. Në vitin 1991 zoti Robo mori detyrën e sekretarit të parë në ambasadën shqiptare në Athinë, detyrë që e mbajti deri në vitin 1994. Pas mbarimit të këtij misioni të rëndësishëm jashtë vendit, në vitet 1994-1995 rikthehet sërish si referent në Drejtorinë e Vendeve Fqinje në Ministri. Duke mos u shkëputur nga rajoni, në vitin 1995 zoti Robo emërohet si këshilltar në Ambasadën e Republikës së Shqipërisë në Sofje dhe, nisur nga eksperiencia në shërbimin e jashtëm, ai ngarkohet me detyrën e hapjes për herë të parë të Ambasadës së Republikës së Shqipërisë në Japoni në vitet 1995-1996. Pas mbarimit të këtij misioni, zotit Robo i ngarkohet drejtimi i Drejtorisë së Vendeve Fqinje deri në vitin 1997. Karriera e zotit Robo pasurohet me marrjen e mandatit të parë të ambasadorit në një vend stratigjikisht të rëndësishëm për Shqipërinë, siç është Greqia, dhe në Qipro, në cilësinë e ambasadorit jorezident në vitet 1997-2002. Në vitet 2002-2007 zoti Robo merr

mandatin e dytë si ambasador i Republikës së Shqipërisë në Mbretërinë e Bashkuar dhe në Irlandë. Pas përfundimit të mandatit të dytë si ambasador, në vitin 2007 zoti Robo kthehet në Ministrinë e Jashtme për të ushtruar detyrën e rëndësishme të drejtorit të Protokollit të Shtetit, të cilin e mbajti deri në vitin 2010.

Këtë vit ai merr mandatin e tretë si ambasador, duke u emëruar rezident në Mbretërinë e Spanjës dhe në Marok, Andora, në cilësinë e ambasadorit jorezident. Ky mandat pasohet nga dekretimi i tij si ambasador në Mbretërinë e Danimarkës, detyrë që e mbajti deri në vitin 2018. Pas kthimit në ministri, zoti Robo drejtoi për një periudhë të shkurtër Drejtorinë e Burimeve Njerëzore dhe më pas, nga nëntori i vitit 2018 e deri tani, zoti Robo ushtron detyrën e drejtorit të Drejtorisë së Amerikës, Afrikës dhe Azisë në ministri.

Siç shihet nga kjo paraqitje e shkurtër karrierën diplomatike mbi 30-vjeçare të zotit Robo do ta kishte zili çdo diplomat, jo vetëm shqiptar. Në këtë karrierë janë ndërthurur në mënyrë të suksesshme eksperiencat me mbulimin e marrëdhënieve me fqinjët, me rajonin, me vendet europiane dhe shtetet e kontinentet e tjera. Gjithashtu, ai ka mbuluar detyra të rëndësishme edhe në Ministrinë e Jashtme. Është pikërisht kjo karrierë e pasur profesionale, sidomos me një fokus të spikatur në çështjet rajonale, që na shtyn ne si institucion ta propozojmë në postin e përfaqësuesit më të lartë diplomatik në Republikën e Turqisë, në një vend që Shqipëria ka marrëdhënie të orientuara drejt partneritetit strategjik, në fushën politike, ekonomike, tregtare, të sigurisë dhe në fusha të tjera.

Perspektiva e marrëdhënieve të gjithanshme me Turqinë, prezenca ekonomike dhe financiare e Turqisë në Shqipëri, roli i rëndësishëm që ky vend luan në zhvillimet ndërkombëtare rajonale, fakti që jemi aleatë në Traktatin e Atlantikut të Veriut, kontributi që Turqia jep në përballimin e valëve të refugjatëve drejt Europës nga Lindja e Mesme e të tjerë bën të domosdoshme që qeveria dhe shteti shqiptar t'i shohin me kujdes të veçantë marrëdhëniet diplomatike me këtë vend, duke ngarkuar për këtë qëllim diplomatin më me eksperiencë që ne kemi dhe me cilësi të spikatura profesionale, që zoti Robo i personifikon më së miri.

Duke besuar se zgjedhja e kandidaturës së zotit Robo është duhura për këtë post të lartë diplomatik, ju ftoj, të nderuar deputetë, ta mbështesni atë duke i paraqitur një rekomandim pozitiv Presidentit të Republikës!

Ne jemi të gatshëm që pas prezantimit të kandidatit për ambasador t'i përgjigjemi çdo lloj pyetjeje apo komenti.

Faleminderit!

Mimi Kodheli –Faleminderit, zoti Skapi!

Zoti Ambasador, fjala për ju.

Kastriot Robo – Faleminderit, zonja kryetare!

E nderuar, zonja kryetare,

Të nderuar zonja dhe zotërinj, anëtarë të Komisionit për Punët e Jashtme në Kuvendin e Shqipërisë,

Për mua është një nder i madh që ndodhem para jush për të paraqitur platformën e punës sime si ambasador i Republikës së Shqipërisë në Republikën e Turqisë. Nominimin tim si ambasador i Shqipërisë në Republikën e Turqisë e vlerësoj maksimalisht dhe e konsideroj si mirënjohje për besimin e treguar, si një detyrë mjaft e rëndësishme në karrierën time diplomatike, të cilën besoj se do ta përballoj me angazhimin tim maksimal, përkushtim, profesionalizëm, përgjegjshmëri dhe atdhedashuri. Shpresoj dhe besoj se do të kem mbështetjen e komisionit tuaj të nderuar ndaj kandidaturës time.

Të shërbesh dhe të punosh si ambasador shqiptar në Turqi është një punë me një vend mik, me të cilin kemi lidhje të thella historike, marrëdhënie tejet miqësore dhe ka qenë e është një partner e aleat strategjik yni.

Kur flasim për marrëdhëniet e partneritetit strategjik të vendit tonë me Turqinë, kjo reflektohet në një bashkëpunim shumëpalësh shqiptaro-turk, ku konvergojnë mjaft interesa kombëtare të shqiptarëve, por edhe në kuadër të NATO-s, në bashkëpunimin tonë rajonal dhe më gjerë.

Marrëdhëniet shqiptaro-turke, për mua personalisht, nuk janë të panjohura, pasi gjatë karrierës sime unë kam punuar edhe si desk i Turqisë në Ministrinë e Punëve të Jashtme, por edhe si drejtor i Drejtorisë së Marrëdhënieve me Vendet Fqinje, ku Turqia ka zënë një nga vendet kryesore. Ajo që bën më shumë përshtypje është se dosja e Turqisë është nga më të plotat në Ministrinë e Punëve të Jashtme. Duke vlerësuar pozitivisht punën e kryer deri tani, me kënaqësi vërej se niveli i marrëdhënieve tona me Turqinë është shumë i mirë dhe me intensitet të vizitave të niveleve më të larta dhe ajo që bie në sy është reciprociteti në shkëmbim të këtyre vizitave. Pra, kemi pasur vizita të dinjitarëve tanë të realizuara në Turqi ashtu siç kemi pasur edhe vizita të liderëve turq në vendin tonë. Aktualisht të dyja vendet dhe qeveritë kanë konfirmuar qartazi vullnetin politik për të forcuar marrëdhëniet dypalëshe, për t'i ngritur ato në nivel partneriteti strategjik, si dhe për të identifikuar fusha të reja bashkëpunimi me të gjithë kuadrin me interes të ndërsjellë, veçanërisht në marrëdhëniet ekonomiko-tregtare.

Nga studimi dhe analiza e dosjes së marrëdhënieve tona me Turqinë shihet fare qartë se Turqia është një partner i vërtetë strategjik dhe mendoj se është e vështirë të gjesh një shtet

tjetër, ku të ketë një konkretizim dhe shtrirje të bashkëpunimit dy dhe shumëpalësh, siç e kemi me Turqinë. Marrëdhëniet e bashkëpunimit me Turqinë unë do t'i konsideroja si marrëdhënie kapilare, pasi nuk kanë lënë asnjë aspekt pa trajtuar dhe shtrihen në të gjitha fushat e interesit reciprok.

Referuar kuadrit ligjor dhe juridik midis dy vendeve tona, ky kuadër është mjaft i gjerë, prek një tërësi fushash bashkëpunimi të realizuara si në një numër të madh marrëveshjesh kuadër, ashtu edhe të detajuara dhe të konkretizuara në mjaft programe, protokolle dhe memorandumë bashkëpunimi, të cilat ndonjëherë duhet të rinovoheshin. Turqia ka qenë një mbështetje jo vetëm ekonomike dhe financiare, jo vetëm materiale dhe teknike, por, mbi të gjitha, një mbështetje morale e një shteti të madh që ka treguar dhe ofruar bashkëpunim gjatë të gjithë viteve të tranzicionit në vendin tonë në mënyrë të pakursyer. Duke iu referuar fushave të bashkëpunimit dypalëshe, për sa i përket bashkëpunimit ekonomiko-tregtar vëmë re se prezenca e investimeve turke në vendin tonë është mjaft e gjerë. Llogaritet që investimet turke në Shqipëri të zënë gati 599 milionë euro investime, është vendi i tretë në renditje, po ashtu edhe shkëmbimeve ekonomiko-tregtare kemi një nivel goxha të lartë.

Për sa i përket pranisë së bizneseve turke, në vendin tonë janë rreth 563 biznese prezente në fushat më të rëndësishme, ku janë të punësuar rreth 10 mijë shtetas shqiptarë. Pra prezenca e bizneseve turke kap të gjitha fushat me interes strategjik, si: Banka Kombëtare Tregtare, Albtelekomi, “Albania Airlines”, që filloj normalisht fluturimet është mbështetur mbi bazën e bashkëpunimit me “Turkish Airlines”, kompania Kurum, Acibadem dhe Eberalb, e cila kryen veprimtarinë e saj në fushën e minierave. Pra, është një prezencë shumë e madhe.

Unë mendoj se kjo është një bazë shumë e fuqishme për të tërhequr edhe investitorë të tjerë strategjikë në të ardhmen drejt vendit tonë.

Po i referohem bashkëpunimit që kemi në fushën e turizmit. Turqia si një vend që është pararojë në zhvillimit e turizmit, në vendin tonë ka dhënë kontribut duke mbështetur zhvillimin e turizmit, por në të ardhmen mendoj se duhet të punojmë për të konkretizuar dhe për të tërhequr investimet turke në fushën e turizmit.

Një bashkëpunim shumë i spikatur me Turqinë është edhe në fushën e mbrojtjes, ku pala turke ka mbështetur jo vetëm anëtarësimin tonë në NATO, por edhe modernizimin e Forcave tona të Armatosura, në shumë aspekte dhe në shumë vektorë, përfshirë dhe arsimimin. Shumë kadetë shqiptarë kanë mbaruar dhe vazhdojnë studimet në akademitë e mbrojtjes së Turqisë, në fushën e forcave ajrore, tokësore dhe detare, por edhe për sa i përket

shëndetësisë ushtarake. Gjithashtu, nëpërmjet garantëve pala turke në vite ka ndihmuar modernizimin me pajisjeve të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë.

Në vendin tonë aktualisht kemi një prezencë të forcave ushtarake turke, mbi bazën e një protokolli bashkëpunimi mes vendit tonë dhe Turqisë në bazën e Pasha Limanit janë 24 ushtarakë turq, oficerë, nënoficerë dhe ushtarakë të thjeshtë. Po kështu kemi edhe një oficer ndërlidhjeje në bazën ajrore të Kuçovës.

Lidhur me bashkëpunimin në fushën e infrastrukturës dhe energjisë, mendoj se kemi një bashkëpunim tepër të gjere në fushën e transportit ajror, detar dhe rrugor.

Për sa i përket bashkëpunimit në fushën e naftës dhe të gazit me realizimin e projektit TAP, pra me ardhjen e sasisë së gazit nga burimet e Kaspikut, nëpërmjet Turqisë, Greqisë, Shqipërisë dhe Italisë, është një projekt shumë i madh, pala jonë do të të kërkojë mbështetjen e palës turke për sa i përket gazifikimit të ekonomisë shqiptare, sepse eksperiencia e tyre është shumë e mirë.

Për sa i përket fushës së energjisë, ne kemi një prezencë shumë të madhe pasi një sërë hidrocentralesh dhe HEC-esh janë në duart e investitorëve turq.

Gjithashtu, bashkëpunimi në fushën e rendit publik është shumë i zgjeruar, si në trajnime, ashtu edhe në operacione të përbashkëta në luftën kundër trafikëve ilegale, krimit të organizuar dhe terrorizmit.

Në fushën e kulturës kemi një marrëveshje kuadër, mbi bazën e të cilës ka një bashkëpunim në fushën e arsimit, shkencës, kulturës, arteve, rinisë, sporteve, medias dhe kontakteve mes njerëzve.

Nëpërmjet agjencisë turke të bashkëpunimit dhe koordinimit “TIKA”, ka shumë projekte grante për rinovimin e mjaft objekteve kulturore me vlerë në vendin tonë.

Gjithashtu, kemi bashkëpunim në fushën e bujqësisë, drejtësisë, shëndetësisë, arsimit e të tjera, se nuk po zgjatem.

Një ndër aspektet që dua të theksoj është problemi i kujdesit për diasporën, pasi në Turqi kemi një diasporë të re dhe të vjetër, e cila shërben si urë e fortë lidhëse në forcimin e miqësisë dhe bashkëpunimit mes dy popujve dhe dy vendeve tona.

Sipas vetë deklaratave të autoriteteve turke, në Turqi ndodhen mbi 5 milion shqiptarë, të cilët janë jo vetëm nga Shqipëria, por nga të gjithë trojet shqiptare në rajonin tonë. Me përpjekjet e përfaqësisë sonë diplomatike në Ankara dhe ambasadës së Kosovës, së fundmi është hapur qendra e kulturës shqiptare në Ankara, e quajtur “Sami Frashëri”, e cila është në mbështetje të mbrojtjes së traditave, zakoneve, kulturës, gjuhës dhe mbështetjes së kësaj diaspore në Turqi.

Një fenomen shumë pozitiv është edhe futja e mësimit të gjuhës shqipe në sistemin arsimor turk, në vitin 2017. Pra, në shkollat e arsimit fillor ka filluar mësimi i gjuhës shqipe, si lëndë me përzgjedhje mbi bazën e kontributit që jep katedra e gjuhës shqipe në Universitetin e Edernesë.

Disa nga prioritetet e punës sime të afërt në drejtim të finalizimit të marrëdhënieve me Turqinë, si një nga prioritetet e qeverisë sonë janë: do të fokusohem te diplomacia ekonomike, mbi bazën e prezencës së investimeve masive turke në vendin tonë, do të përpiqem për të tërhequr investimeve në fusha të tilla si: energjia, turizmi, mjekësia arsimi, bujqësia, infrastruktura dhe transportet.

Gjithashtu, diplomacia publike do të jetë një nga prioritetet e punës sonë, duke u përpjekur për promovimin e vendit tonë në medie, Ministrinë e Jashtme, me ministrinë e linjës, trupit diplomatik dhe konsullor, duke qenë aktiv edhe me rrjetet sociale të ambasadës sonë.

Nisur edhe nga eksperiencia profesionale do të përpiqem të jem sa më aktiv dhe të nxis punën dhe bashkëpunimin dhe të maksimalizoj të gjithë burimet dhe kapacitetet e ambasadës sonë në Ankara, si dhe konsullatës në Stamboll, bashkëpunimin me ambasadën e Kosovës, por njëkohësisht edhe veprimtarinë e konsujve tanë të nderit që kemi në Turqi.

Pra, një nga objektivat imediate të punës do të jetë nënshkrimi i deklaratës së përbashkët për themelimin e këshillit të bashkëpunimit të nivelit të lartë, teksti i së cilës është përafëruar nga dy ministrat e jashtëm vitin e kaluar.

Duke ju falënderuar për mirëbesimin dhe mbështetjen, shpreh bindjen se me punën dhe përpjekjen time do të përmbush me sukses besimin që më jepni të shërbej si ambasador i Republikës së Shqipërisë në Republikën Turke.

Faleminderit!

Mimi Kodheli – Faleminderit, ambasadori Robo!

A ka pyetje nga kolegët? Pasta do të kalomë në diskutime. Po, zoti Gjoni.

Ralf Gjoni – Vetëm pyetje?

Mimi Kodheli – Po vetëm pyetje, sepse edhe unë kam pyetje.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Faleminderit, nënkryetar!

Zoti Ambasador, kam një pyetje, mbase shumë e guxuar, por më lind e drejta për shkak se jam anëtare e parlamentit shqiptar. Në Republikën e Turqisë ndodhen eshtrat e Sami Frashërit, i cili një pjesë të veprës së tij e ka në atë vend, por i përket Shqipërisë. Në momentin që morët këtë propozim, a keni menduar se mund të vijë një ditë, duke pasur

angazhimin tuaj dhe angazhimin e qeverisë dhe parlamentit shqiptar, që eshtrat e Samiut të vijnë në Shqipëri? E di që është e guximshme, sepse duket si mision i pamundur. Kjo ishte pyetja ime për ju.

Kastriot Robo – Janë bërë përpjekje për kthimin e eshtrave të Sami Frashërit në Shqipëri shumë vite më parë, por ka qenë e pamundur për shkak të vlerësimit që qeveria dhe pala turke kanë për figurën e Sami Frashërit. Ai është një figurë kombëtare edhe për turqit me sa ka ofruar ai për kulturën dhe historinë e Turqisë, përfshirë hartimin e disa fjalorëve të parë, krijimin e ekipit të futbollit të “Gallata Sarajit”. Pra, është personalitet. Unë mendoj se nuk është e pamundur dhe do ta ndjek me prioritet këtë çështje gjatë misionit tim atje.

Mimi Kodheli -Zoti Gjoni, fjala për ju.

Ralf Gjoni- Zoti Robo, faleminderit për prezantimin tuaj shterues dhe dinjitoz, siç i ka hije një diplomati karriere dhe një ish-kolegu, kontributin e të cilit unë e kam vlerësuar maksimalisht në Ministrinë e Jashtme!

Kam një pyetje, me të cilën nuk dua t’ju vë në pozitë, sepse e kuptoj rolin tuaj si ambasador i pritshëm në Turqi, por duke marrë shkas nga një vizitë e një delegacioni parlamentar turk ditët e kaluara, gjatë një takimi të zhvilluar me Kryetarin e Kuvendit, zotin Ruçi, Zoti Ruçi shprehu atë qëndrim që shumica e politikanëve shqiptarë shprehin shpesh në takimet bilaterale me palën turke, që marrëdhëniet e Shqipërisë me Turqinë janë strategjike, për shkak të lidhjeve historike, bashkëpunimit intensiv politik, partneritetit të ngushtë në NATO, rolit në Ballkan, mbështetjes turke nga ana ekonomike ushtarake dhe ndaj Kosovës, por nga ana tjetër vihet re se gjatë viteve të fundit ka një diskordancë politike në qëndrimet politike të qeverisë turke dhe Perëndimit. Ju, si ambasador i Shqipërisë në Ankara, çfarë mendimi keni sa i përket terminologjisë: lidhje dhe bashkëpunimin intensiv politik mes Tiranës dhe Ankarasë në një spektër më të gjerë rajonal? A mendoni se ka nevojë për intensifikim të mëtijshëm të marrëdhënieve midis Shqipërisë dhe Turqisë, duke pasur parasysh edhe rolin ndërlidhës të Turqisë në rajonin më të gjerë se Ballkanin, të Europës Juglindore në lidhje me Rusinë dhe Azinë? Pra, si e gjykoni ju intensifikimin e mëtijshëm dhe si duhet përqasur marrëdhëniet dhe bashkëpunimi ynë politik me Turqinë? Nuk dua t’ju vë në pozitë, po do të doja të dija vlerësim tuajin në lidhje me ushtrimin e detyrës në Ankara.

Ligoraq Karamelo – Faleminderit!

I nderuar zoti ambasador, unë që në fillim do të shpreh konsideratat dhe vlerësimet e mia më të larta për ju dhe kontributin tuaj. Pa dyshim jam shumë dakord me emërimin tuaj.

Unë kam disa pyetje. Së pari, ne tashmë e dimë se ka shumë ambasadorë që u ka kaluar afati, por fakti që ata nuk po zëvendësohen tregon një përplasje midis Presidentit dhe

Kryeministrit. Kjo është evidente. Ky zëvendësim që po bëhet sot për çfarë arsyeje po bëhet, për arsyen se mandatit të ambasadorit në Turqi i ka mbaruar afati? A ka ndonjë problem? Apo diçka fshihet aty? Këto pyetje i drejtohen Sekretarit të Përgjithshëm.

Ndërsa për ju, zoti ambasador, kam dy pyetje. Së pari, ne e dimë që Turqia ka një rol të fuqishëm në Ballkan dhe pa dyshim që ky rol ka influencat e veta në politikën rajonale, në proceset e reja të krijimit të shengenit ballkanik ose edhe të situatave të reja që priten të ndodhin si pasojë e formimit të qeverisë së Kosovës. Kemi një Turqi që ka marrëdhënie shumë të mira me pothuajse të gjitha vendet, por kemi edhe një Turqi që nuk ka marrëdhënie të mira me SHBA-të, mbase edhe me Perëndimin. Ju si e shihni rolin e Turqisë në rajon?

Marrëdhëniet në mes dy vendeve tona janë shumë të mira, por shpeshherë ne shikojmë se në këto marrëdhënie ndjehen disa tendenca vasaliteti të diplomacisë sonë ndaj diplomacisë turke, për të mos thënë edhe disa tendenca presioni nga ana e palës turke në drejtim të palës shqiptare, sidomos në drejtim të sektorit të fesë dhe të arsimit. Ju si i gjykoni këto? Nuk duhet të fshihemi prapa gishtit! Fakti që në Tiranë ka probleme me vendosje memorialësh ose me institucionet arsimore dhe fetare, tregon se ne bëjmë atë që na diktojnë. Ju si i shikoni këto zhvillime?

Mimi Kodheli – Zonja Kushi.

Evis Kushi – Faleminderit!

Edhe unë shpreh konsideratën për kandidaturën e zotit Robo.

Kam një pyetje që lidhet me marrëdhëniet ekonomike tregtare midis dy vendeve tona. Ju thatë se një nga prioritetet e punës suaj do të jetë pikërisht intensifikimi i marrëdhënieve ekonomike tregtare. A keni ju disa objektiva më konkretë dhe më specifike, më të matshëm? Mbase është herët për të pasur një plan konkret, por mbase disa objektiva kryesore specifike mund të na i thoni.

Mimi Kodheli -Zonja Hysi.

Vasilika Hysi –Faleminderit!

Faleminderit për prezantimin.

I nderuar ambasador, unë kam një pyetje lidhur me përparësitë që ju thatë. Ju thatë se diaspora e vjetër dhe e re do të jetë në vëmendjen tuaj, do të doja të dija se në strategjinë tuaj si ambasador në Republikën e Turqisë çfarë mendoni për të bërë në lidhje me diasporën e re dhe të vjetër?

Fate Velaj– Me sa lexova në CV-në tuaj shikoj se keni qenë një herë ambasador, një herë sekretar i parë në Athinë. Me sa di unë marrëdhëniet midis Ankarasë dhe Athinës nuk janë aq të lulëzuara. Ka problematika që agravanojnë ose fillojnë dhe majisen. Me

eksperiencën tuaj si një diplomat karriere, si do t'i shikoni ju marrëdhëniet mes Greqisë dhe Stambollit? Në të dyja vendet jetojnë diaspora shumë frytdhënëse shqiptare.

Mimi Kodheli- Para se të merrni fjalën për t'u përgjigjur desha t'i jap përgjigje njëjërës nga pyetjet që shtroi kolegu Karamelo, këtë e them, sepse dua t'ju tërheq vëmendjen. Kemi kërkuar si Komision i Jashtëm prezencën e ministrit në detyrë për Europën dhe Punët e Jashtme, zotit Cakaj, lidhur me një nga problematikat që shtroi zoti Karamelo, emërimet dhe axhendën tuaj lidhur me vazhdimin e këtij procesi, largimin nga detyra të atyre që e kanë mbushur mandatin. Nuk dua të përgjigjeni për këtë, por desha vetëm ta sillja në vëmendjen tuaj këtë gjë, ndërkohë që jeni të lutur ju fillimisht dhe pastaj ambasadori e me radhë kolegët të përgjigjeni.

Armand Skrapi – Faleminderit, zonja kryetare!

I nderuar zoti Karamelo,

Në lidhje me pyetjen tuaj, dëshiroj t'ju sqaroj se propozimi i kandidaturës së zotit Robo është bërë në përputhje me dispozitat e ligjit për shërbimin e jashtëm, nisur nga fakti që ambasadori aktual në detyrë, zoti Gazheli ka paraqitur kërkesën për dorëheqje. Kjo është një praktikë e parashikuar nga ligji i shërbimit të jashtëm, në qoftë se një titullar i misionit diplomatik kërkon dorëheqjen me mirëkuptimin edhe të autoriteteve emëruese, kjo procedurë realizohet dhe institucioni vepron menjëherë me paraqitjen e kandidaturës së re. Duke qenë se marrëdhëniet me Turqinë, siç u përmend, janë të një rëndësie strategjike, nuk mund ta lëmë për një kohë të gjatë vendin vakant, por duhet të procedojmë me normalitetin e duhur që e parashikon edhe ligji me propozimin e një kandidature të re.

Besoj se ju dhashë sqarimin e duhur.

Faleminderit!

Mimi Kodheli – Zoti ambasador, fjala për ju, duke filluar nga pyetjet e zotit Gjoni.

Kastriot Robo – Faleminderit, zonja kryetare!

Lidhur me pyetjen e zoti Gjoni, në radhë të parë e falënderoj për vlerësimin që ai bëri ndaj meje, por njëkohësisht vlerësoj edhe analizën që bëri sa i takon rolit strategjik të Turqisë në marrëdhëniet me Shqipërinë. Është e vërtetë që ndonjëherë artikulohet për sa i përket orientimit strategjik europian të vendit tonë, por shpesh flitet për influencë të vendeve të treta ndaj vendit tonë. Unë mendoj që rasti i Turqisë nuk lidhet nuk influencën e faktorëve të tretë, pasi marrëdhëniet tona janë marrëdhënie historike, janë marrëdhënie me një bazë shumë të gjerë dhe shpresoj, si dhe do të punoj për forcimin e mëtejshëm të marrëdhënieve shqiptaro-turke gjatë misionit tim atje.

Pra, nuk mendoj dhe gjykoj që do të ketë një proces frenues ndaj komenteve që bëhen.

Faleminderit!

Sa i takon pyetjes së zotit Karamelo, është e vërtetë që roli dhe rëndësia e Turqisë në rajonin tonë është rritur. Unë mendoj dhe gjykoj që me këtë rol të rritur të Turqisë ne duhet të vazhdojmë t'i thellojmë më tej marrëdhëniet e bashkëpunimit tonë dypalësh.

Sa i përket komentit që u bë se shpesh vihen re tendenca presioni ose një tendencë vasaliteti në qëndrimet tona ndaj palës turke, nuk gjykoj se është i tillë, pasi bashkëpunimi ynë mbështetet mbi baza reciproke. Siç e theksova, kemi një kuadër ligjor të plotë dhe do t'i mbështesim dhe do t'i avancojmë marrëdhëniet tona bazuar në këtë bazë të plotë ligjore. Edhe në këtë aspekt mendoj që ne do të avancojmë në marrëdhëniet e bashkëpunimit tonë në të ardhmen.

Lidhur me pyetjen që bëri zonja Kushi për sa i përket marrëdhënieve ekonomiko-tregtare ndërmjet dy vendeve tona dhe nëse kemi objektiva të matshëm dhe specifikë, ndoshta është shpejt ta gjykoj, sepse nuk i jam futur aq thellë realitetit, por shoh që diçka është shumë pozitive. Kemi një bazë shumë të mirë të marrëdhënieve dhe bashkëpunimit ekonomiko-tregtar mes dy vendeve tona, kemi një prezencë të qenësishme të biznesit turk në Shqipëri, gjë që mendoj se është një faktor plus për të lehtësuar punën për tërheqjen e investimeve të tjera turke drejt vendit tonë. Në qoftë se në vende të tjera unë jam përpjekur të sillja një kompani, për shembull, që të ishte prototip dhe të tërhiqte investitorë të tjerë pas vetes, ishte diçka shumë e vështirë, këtu do t'i referohem asaj formulës së famshme të Harvardit “300, 30, 3”, domethënë duhen të bëhen 300 kontakte, 30 të binden të vizitojnë Shqipërinë dhe 3 të mund të investojnë në Shqipëri dhe kjo nuk është gjë e lehtë, por terreni është shumë pozitiv dhe mendoj që perspektiva dhe e ardhmja e gjërave është pozitive.

Gjithashtu, edhe në aspektin e promovimit të imazhit të vendit tonë, besoj se me promovimin sa më shumë të imazhit të vendit tonë nxitja dhe thithja e investimeve turke drejt ekonomisë shqiptare do të jetë më e madhe.

Zonja Hysi, ju falënderoj për pyetjen!

Realisht puna me diasporën është një aspekt i rëndësishëm i punës sonë. Tashmë me krijimin e Ministrisë së Diasporës ne do të krijojmë programe më të plota për t'i qëndruar sa më afër kësaj diaspore. Është fakt që prezenca e diasporës shqiptare në Turqi është tepër masive. Ish-presidenti turk Demirel ka deklaruar që diaspora shqiptare në Turqi është më e madhe se popullsia e vetë Shqipërisë, ndërsa ambasadori turk në Tiranë ka deklaruar që flitet për një diasporë mbi 5 milionë shqiptarë në Turqi, gjë që është një front shumë i madh pune

për ne. Unë mendoj që hapat janë hedhur me krijimin e qendrës kulturore “Sami Frashëri” në Ankara, së bashku me ambasadën e Kosovës, futjen e mësimit të gjuhës shqipe në programet mësimore të Turqisë që nga viti 2017, mbi bazën e mbështetjes që ka bërë katedra e gjuhës shqipe në Thrakën Perëndimore. Mendoj se këta janë faktorë bazikë mbi të cilët duhet të përpiqemi në të ardhmen për ta nxitur këtë diasporë që të ruajë lidhjen me Shqipërinë.

Sa i takon pyetjes së zotit Velaj lidhur me analogjinë e marrëdhënieve ndërmjet Greqisë dhe Turqisë, mendoj se secila ka specifikën e vet, kohën, vendin, por të dy vendet janë mjaft të rëndësishëm, sepse janë vende fqinj dhe kanë një prezencë të madhe shqiptarësh, prandaj edhe bashkëpunimi ynë është tepër pozitiv. Besoj se eksperiencia dhe puna që kam bërë në Greqi do të më ndihmojnë më shumë për punën në postin e ambasadorit në Republikën e Turqisë.

Faleminderit!

Mimi Kodheli – Faleminderit, zoti ambasador!

A ka pyetje të tjera?

Zoti Bushati, fjala për ju.

Ditmir Bushati – Faleminderit, zonja kryetare!

Faleminderit zoti Skapi dhe zoti Robo për prezantimin!

Kam një koment të përgjithshëm, pasi e ndiej që del si temë në Komisionin e Politikës së Jashtme, si edhe në komisionin e kaluar, sa i përket politikës së burimeve njerëzore. Dua të rikonfirmoj qëndrimin tim sa i përket politikës së burimeve njerëzore, pasi ligji është i qartë se kujt i përket kompetenca për ta ushtruar politikën e burimeve njerëzore në shërbimin e jashtëm dhe ky komision besoj se nuk ka një rol thelbësor në këtë proces. Po ashtu duhet të kuptojmë që seanca të tilla dëgjimore nuk e kanë pajisur këtë komision me një tagër vendimmarrës. Kjo është një seancë, e cila na krijon neve një përshtypje më të qartë, mund të na ndriçojë për aspekte të caktuara qoftë për mënyrën sesi agjentët diplomatikë shqiptarë mund të ushtrojnë politikën e tyre të jashtme, të shtetit shqiptar kuptohet, në vendin ku ata do ta përfaqësojnë Shqipërinë, por ligji, Kushtetuta në emërimin e një ambasadori janë të qarta. Sikundër, nuk është as blasfemi që një ambasador të qëndrojnë në detyrë, sepse nuk bëhet fjalë për mandat kushtetues. Ne kemi qenë të qartë dhe kemi folur për kohëqëndrimin në detyrë. Në momente të caktuara kreu i diplomacisë mund të mendojë që një ambasadori i duhet të jetë në një vend apo në një vend tjetër, por njerëz me eksperiencë si puna e zotit Robo mund të thirren edhe pa qëndruar 3 vjet në Turqi për të shkuar diku tjetër, ku mund të ketë nevojë ekzekutivi apo shërbimi i jashtëm. Prandaj ky komision ia vlen që të merret me

politikë të jashtme dhe jo më burime njerëzore, sepse ky është tagri ynë dhe ne kemi për detyrë të kontrollojmë qeverinë në ushtrimin e politikës së jashtme, por deri këtu.

Kjo ishte pika e parë që doja të ngrija.

Çështja e dytë ka të bëjë me kandidaturën, e zotit Robo, i cili mendoj se është një nga diplomatët më me eksperiencë në shërbimin e jashtëm dhe në gjykimin tim është rasti kur përputhet plotësisht rëndësia që Shqipëria i jep vendit, ku do të shërbejë zoti Robo, me kandidaturën që ne i propozojmë Turqisë për raportin, i cili u sqarua këtu, ndërmjet Shqipërisë dhe Turqisë.

Në këtë kontekst, besoj se zoti Robo është, siç e tha me të drejtë zoti Skapi në shërbimin e jashtëm një figurë serioze. Di një histori kur i patëm çuar njëherë letrat për të kërkuar agreementin dhe shkoi në një vend të caktuar (nuk po e themi këtu), zotëria që i pa, drejtori i protokollit të shtetit të vendit pritës tha “I munguaka në CV vetëm Ministri i Punëve të Jashtme si pozicion”. Pra në këtë pikëpamje, mendoj që kemi të bëjmë me një kandidaturë profesioniste, serioze dhe e mirëkuptoj ngërçin në dhënien e disa përgjigjeve për sa kohë kjo është një seancë e hapur. Zoti Skapi më ka thënë që janë duke e riparë ligjin dhe unë kam ngulmuar që nuk do të ishte keq sikur t’i rikthehemi traditës që kanë një pjesë e mirë e vendeve ku prezantimi bëhet pasi ambasadori e ka ezauruar të gjithë ciklin, ka marrë dhe dekretin e Presidenti dhe, mbi të gjitha, ka marrë pëlqimin e vendit ku do të shërbejë.

Pika e tretë ka lidhje me Turqinë dhe me prezantimin që u bë. Që nga viti 2013 ne e kemi përfshirë Turqinë si partner strategjik, bashkë me Italinë dhe Greqinë, në rajon. Ka pasur shumë diskutime dhe keqkuptime për këtë përfshirje të Turqisë, por mendoj se është një realitet thjesht historik, por edhe faktik. Nga ana tjetër besoj se duhet të jemi të lëmuar dhe të kujdesshëm, sepse edhe në prezantimin që u bë dëgjova që u tha se niveli i marrëdhënieve me Turqinë është si me asnjë vend tjetër. Mendoj se duke i shkuar me radhë vendeve të tjera them se ka një radhë si në çdo proces tjetër dhe besoj se këtu duhet t’i përmbahemi traditës dhe devizës sonë të politikës së jashtme, të hapur në Mesdhe, por të kyçur në Ballkan. Në këtë drejtim linja jonë dhe hapat tona fillojnë fillimisht me Italinë, për të vazhduar më pas me vende të tjera, pavarësisht dëshirës dhe vullnetit që mund të këtë një ambasador për t’i fuqizuar marrëdhëniet me vendin, ku do të shërbejë, sepse jo çdo gjë është në duart e ambasadorit aq më tepër që ne kemi zhvillime shumë të rëndësishme, ku një pjesë e mirë e çështjeve zgjidhen ose në nivel kryetarësh shtetesh, kryeministrash ose ministrash.

Çështja që më ngacmoi pak dhe besoj se është e rëndësishme ta trajtojmë në kuadër të realizmit, ka të bëjë me shifrën 5 milionëshe dhe me citimet e ish-Presidentit të nderuar turk Demirel, apo të ambasadorit në Tiranë për 5 milionëshin. Duhet të jemi shumë të

kujdesshëm, pasi nuk na ka hije të flasim për territore shqiptare, sepse zoti Skapi është drejtues i grupit të punës edhe në një shtet tjetër, me të cilin jemi të përfshirë në një proces standardizimi europian për mënyrën si i referohemi. Shqiptar dhe territore shqiptare nuk janë domosdoshmërisht e njëjta gjë. Siç e thatë edhe ju, zoti Robo, ne e kemi bërë një hap për sa i përket qendrës kulturore dhe dokumentit të partneritetit strategjik që është i përafëruar në nivel ministrash, por ende nuk është fuqi, megjithatë kjo nuk e ka penguar as Shqipërinë e as Turqinë për t'i zhvilluar marrëdhëniet. Ndoshta ky është momenti përcaktues që, bashkë me përfaqësinë e Kosovës në Turqi, të hedhim një hap tjetër. Nuk e kemi përmbushur ende zotimin për të bashkuar konsullatat në Stamboll, siç e kemi bërë me Kosovën nëpër vende ku ka diasporë shqiptare, sikundër ekzistojnë të gjitha mundësitë dhe disponibiliteti i palës turke që të shkojmë me një ambasadë më të përforcuar në Turqi bashkë me Kosovën dhe të kemi programe të reja për sa i përket diasporës shqiptare atje, pavarësisht se ku kanë lindur dhe nga vijnë.

E fundit, për sa i përket raportit dhe Turqisë si aktor i tretë në Shqipëri, aktor i tretë në kuptimin që nuk është as SHBA-ja e as BE-ja, dhe fakti që është aktor i tretë nuk do të thotë që ne e barazojmë me aktorë të tjerë të tretë, të cilët tradicionalisht dhe historikisht kanë qenë dhe e konsiderojnë Ballkanin një tryezë shahu gjeopolitik dhe janë këtu.

Në këtë kontekst besoj se kemi kthjelltësinë e nevojshme për të bërë diferencat në qëndrime ndryshe, jo vetëm në NATO, por edhe në Këshillin e Europës kur vjen fjala për disa çështje të rëndësishme, apo dhe për çështje e ngritura nga zoti Karamelo, të cilat janë bërë vijimisht nga Shqipëria, duke ndjekur rrugën diplomatike dhe duke u bazuar tek e drejta ndërkombëtare.

Për të ardhur tek investimet dhe biznesi turk në Shqipëri, besoj se duhet të jemi gjithashtu të kujdesshëm. Nuk bëhet fjalë për Bankë Kombëtare Turke, por për Bankë Kombëtare Tregtare. E them këtë edhe për shkak të eksperiencës. Në të dyja rastet ka qenë këmbëngulja e qeverisë shqiptare të kohës si për BKT-në, si për Albtelekomin, ashtu dhe për *Eagel*-in, që simbolet shqiptare të mos fshiheshin, por të ruheshin dhe ndoshta ky ka qenë një nga ato rastet e mira dhe ideale ku ka pasur një bashkëpunim pikërisht për të shmangur çdo lloj keqkuptimi që mund ta pikturonte situatën si kthim në shekujt e kaluar, kur dihet se cila ka qenë historia jonë me Perandorinë Osmane.

Zonja kryetare, duke ju falënderuar për durimin, dua t'i uroj ambasadorit Kastriot Robo punë të mbarë, sepse është ezauruar cikli i konsultimeve për t'ju përgjigjur shqetësimit të zotit Karamelo. Jam gjithashtu i bindur që zoti ambasador do të shërbejë me dinjitet dhe përkushtim në Turqi.

Faleminderit!

Mimi Kodheli – Faleminderit, zotit Bushati!

Durimi im ka të bëjë gjithmonë se sa shterues jeni dhe këtë herë keni qenë shumë shterues...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Patjetër që jeni drejtë rrugës së përmirësimit, prandaj nuk do ta kem asnjëherë problem të dëgjoj ato që thoni.

Fjala për ju, profesor Marto.

Andrea Marto – Faleminderit, zonja kryetare!

Faleminderit Sekretar i Përgjithshëm dhe ju zoti ambasador për prezantimin!

Unë e mora fjalën sepse zotin Robo e njoh prej 35 vjetësh, e kam njohur që kur ka filluar studimet pasuniversitare dhe e kam ndjekur më pas në karrierën e tij. Kam bashkëpunuar sipas rastit në postet e ndryshme dhe kur qenë ambasador, dhe kam konstatuar që ka qenë një nga ambasadorët, i cili e ka përfaqësuar denjësisht Shqipërinë. Me rastin e kësaj dëgjese përgëzoj ministrin e Jashtëm për propozimin dhe shpreh bindjen time se Shqipërisë i nevojiten ambasadorë të tillë. Emri i zotit Robo e nderon vendin tonë dhe përfitoj nga rasti t'i uroj suksese në detyrën e re.

Faleminderit!

Mimi Kodheli – Faleminderit kolegë!

Falënderoj Sekretarin e Përgjithshëm!

Falënderoj ambasadorin!

Ju uroj punë të mbarë dhe shpresoj që Presidenti ta dekretojë shumë shpejt dhe të filloni sa më shpejtë që të jetë e mundur punën tuaj!

Këtu po e mbyll mbledhjen.

Ditë të mbarë!

MBYLLET MBLEDHJA